

Data \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**Sherbimi i ruajtjes dhe shoqerimit t vlerave monetare per Njesine e Koordinimit Korce FSHU SH.A**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79713000-5**  
Sherbime te Sigurimit ( Roje )

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**14014974.7(katermbedhjetemilionkatermijenenteqindeshatatedhjetekaterpikeshtate)leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Ky sherbim shtrihet ne te gjithe agjensite (Korce, Pogradec, Bilisht, Erseke) ku Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a, ushtron aktivitetin ndaj, nuk mund te ndahet ne lote.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Xhiroja mesatare vjetore gjate tre viteve te fundit te kete nje vlere sa vlere e fondit limit te Marrveshjes Kuader

**14014974.7(katermbedhjetemilionkatermijenenteqindeshatatedhjetekaterpikeshtate)leke pa TVSH**

Per kete Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlora e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe *parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 ”Per Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e përcaktuar ne udhezimin e Ministrisë të Financave ne zbatim te ketij Ligji.*

---

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. License e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare nenkategoria 1.3 B leshuar nga QKL.

2. Certificate e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së Ruajtjes dhe shoqërimin të vlerave monetare nenkategoria 1.3B

3.Certifikata per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe shoqerimin e vlerave monetare per te pakten 10(dhjete) punonjes sherbimi leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise se Qarkut Korce, shoqeruar me vertetimin leshuar nga Administrata Tatimore per numrin mesatar te punonjesve te siguruar per periudhen Janar- Qershor2023 gjithashtu shoqeruar me formularin E-sig 025”Listpagesat e sigurimeve shoqerore”. Punonjesit qe figurojne te rregjistruar ne vertetimin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise se Qarkut Korce, duhet detyrimisht te jene rregjistruar ne listpagesat per periudhen e kerkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshem.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshem dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

---

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

1.Deshmi per sherbime te meparshme te ngjashme ne nje vlere sa 40% e vleres se fondit limit te Marreshjes Kuader, te kryera gjate tre viteve te fundit.

Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat si deshmi pranohen vetem faturat tatimore te shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se shërbimi i sigurisë për ruajtjen e ndërtesave, aseteve, njerëzve dhe pronave është një shërbim shumë i rëndësishëm, është parë e arsyeshme që operatori ekonomik duhet të ketë eksepriencë të mëparshme për të garantuar shërbimin e kërkuar dhe për të vërtetuar aftësitë e tij.

---

2. Akti i miratimit të Qendres së Kontrollit, miratuar nga Drejtoria e Policisë Vendore të Qarkut ku ushtron aktivitetin SHPSF duke përfshirë vendin e prokurimit që prokurohet në rang Qarku.

a) Ligji Nr.75/2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike Neni 22

b) Udhëzim Ministri i Brendshëm Nr 130 datë 5.3.2018 Model-19 Model -20

c) Për vërtetimin e Qendres së Kontrollit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Dokument pronesie/qiraje të vendit/selise ku ushtron aktivitetin shoqëria ofertuese.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligji 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe Ligji Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

---

3. Vërtetim për performancën mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Korçë, ku të jepet informacioni i sipërkerkuar.

4. Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë së SHPSF nuk ka masa administrative dhe ngjarje në të gjitha Njesitë Vendore, ku është e rregjistruar ose ka qene e rregjistruar sipas Ekstraktit Historik të lëshuar nga QKB për vitet 2021,2022.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligji 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar si dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të kontratës. Informacioni i kërkuar, si psh nr. i punonjësve të shërbimit, numri i objekteve me sinjal alarmi që duhet të ofroje këtë shërbim, janë në përputhje me përmasat e kontratës që do të realizohet, e konkretisht me numrin e objekteve/vendrojeve ku do të kryhet shërbimi, dhe numrin e punonjësve të shërbimit që do të kryejnë shërbim.

---

5. Shoqeria duhet të disponojë minimalisht 5 (pese) arme krahu B.4 dhe një armë brezi të kategorisë "B1" sipas Ligjit 75/2014.

Operatori ekonomik për të vertetuar faktin e pronësive të 5 (pese) armëve B1 dhe 1 (një) armë krahu B4 duhet të disponojë gjithashtu dhe dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për blerjen e armëve të zjarrit.
- Kontrata shitblerjeje armë me një shoqëri të licensuar
- Fatura tatimore për blerjen e armëve si dhe pagesën e tyre
- Faturën e magazinës SIMA (sistemi Informatizuar i Menaxhimit të Armëve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korce.
- Autorizim të përdorimit të armës së punonjësve të licensuar (5 punonjës)

Autoriteti kontraktor para se të nxjerre vlerësimin do të bëjë verifikimin e Qendres Kontrollit, sipas elementeve përberës të Udhezimit MB nr 157 datë 01.04.2015 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", për çdo Operator Ekonomik pjesëmarrës në tender, mungesa e njërit prej tyre është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata dhe të shkurtra) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit 74/2014 "Për armët" si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Numri i armëve 5 (pese), është përcaktuar në bazë të numrit të qendrave të KNK.

---

6. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për muajt fundit (Janar 2023-Qershor 2023) shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore ( formularët E-sig 025a) për këto periudha të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 (dhjetë) punonjës të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Duke llogaritur numrin e qendrave të kujdesit të klientit për të cilat do të ofrohet shërbimi.

---

7. Autorizim individual në emër të shoqërisë për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të leshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet

elektronike ne Republiken e Shqiperise”, me zone mbulimi zonen ku do te kryhet sherbimi Korce, Pogradec, Bilisht, Erseke.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.*

---

8. Vertetim nga Njesia Vendore perkatese per pagesen e detyrimeve dhe taksave vendore , per vitin 2020, 2021, 2022 ne te gjitha Njesite ku OE eshte i rregjistruar, ose ka qene i rregjistruar sipas Ekstraktit Histoik te leshuar nga QKB.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në **neni 77 pika 3 i LPP)**

---

9. Ofertuesi duhet te disponoje se paku 5(pese) automjetet te blinduar ne pronesi te shoqerise apo te mara me qera. Per kete OE duhet te paraqese:

-Autorizimet nga Drejtoria e Policise se Shtetit Tirane

-Ne autorizim te jene emrat e punonjeve te sherbimit te kategorise 1.3 B

-Leje qarkullimi dhe vertetim per shlyerjen e taksave te automjetit ne pronesi te shoqerise.

Ne rastin kur automjeti eshte mare me qera, Leja e Qarkullimit duhet te shoqerohet dhe me kontraten noteriale te marrjes me qera, ku te jete percaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qira.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i automjeteve është kërkuar në bazë të numrit të qendrave të KNK që do të ofrojnë shërbimin, gjithsej janë 5 (pese).

---

10. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur (shih Shtojca 1-Sqarime)

**Argumentimi:** *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një roje në muaj). Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin e ofertës duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (si psh: pagë bazë, shtesat mbi pagë turni I+III, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nënkoston ligjore dhe do të skualifikohen.*

---

11. CV e shoqërisë dhe stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 14 pika 2 I VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Do të realizohet shërbimi i shoqerimit të vlerave monetare si me poshte me Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit (Qendrat KNK) dhe Arkat e Pageses së Energjisë Elektrike objekte të FSHU sh.a.

- Shoqerimi i sigurve të punonjësve (arketareve) nga fillialet e FSHU sh.a drejt filialeve të bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.
- Punonjësi i FSHU sh.a. ( arketari/rja) duhet të shoqerohet nga dy roja të armatosura,
- Rojat duhet të jenë të pajisura me armatim sipas ligjeve në fuqi, si edhe me mjete speciale për përballimin e situatave, nga sulme të mundshme me qëllim grabitjen e vlerave monetare ( Jelek antiplumb, Sprei, Pistoletë elektrike etj)
- Shoqerimi duhet të kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqerimit, mjeti duhet të jetë i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare të kryejë shoqerimin e vlerave monetare.
- Shoqerimi i vlerave monetare do të kryhet një ose dy herë në ditë, sipas instruksioneve të personave përgjegjës të FSHU sh.a, nga dita e Hënë - Diele.
- Distanca që duhet të mbulohet nga kompania e shoqerimit, nga KNK/Arka deri në filialin me të afërt të bankës do të jetë maksimumi 10 km ( one way) ose 20 km ( vice-versa).
- Koha maksimale e procesit të shoqerimit të vlerave monetare do të jetë 40-60 min.
- Koha orare e shoqerimit të vlerave monetare do të jetë :
  - Turni i parë nga ora 15:00-16:00
  - Turni i dytë nga ora 20:00-21:00
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformën dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" të publikuar në fletorën zyrtare datë 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.



## **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

#### **Shërbimi që kërkohet:**

Shoqërimi dhe sigurimi i vlerave monetare të FSHU sh.a Rajoni Korçe për një periudhë 2 vjeçare; Marrëveshje kuadër - Me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Qendra e KNK në qytetin Bilisht [Turni i Pare + Turni i dytë]

Qendra e KNK në qytetin Pogradec [Turni i Pare + Turni i dytë]

Qendra e KNK në qytetin Erseke [Turni i Pare ]

Qendra e KNK në qytetin Korçe [Turni i Pare + Turni i dytë]

Qendra e KNK në qytetin Maliq [Turni i Pare + Turni i dytë]

#### **Afatet e ekzekutimit:**

24 (njëzet e katër) muaj i parashikuar.

Kontratat do të jepen nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të Autoritetit Kontraktor me afat përfundimtar 24 (njëzet e katër) muaj

## **Shtojca 7**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekt i Shërbimit do të jetë Transporti i Vlerave Monetare nga Objektet e Autoritetit Kontraktor për në Banke me punonjës shërbimi, sipas përcaktimeve në Shtojcën 5 "Specifikimet teknike" dhe Shtojcën 6 "Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit" duke garantuar paprekshmerinë e tyre fizike.

Detyrat: Çdo punonjës i shërbimit, titullari i subjektit të SHPSF-së, si dhe drejtuesi teknik duhet të kryejnë me përgjegjësi të gjitha detyrat e përcaktuara në Ligjin Nr. 75/2014 'Për shërbimin privat të sigurisë fizike' të publikuar në fletoren zyrtare datë 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.

Shpërndarja: Kërkohen punonjës shërbimi të shpërndarë sipas Shtojcës Nr.6

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Kërkohen punonjës shërbimi të shpërndarë sipas Shtojces Nr.6

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Korce, Pogradec, Bilisht, Erseke, Maliq.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: specifikimet teknike, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**